



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2023:286838

Datë: 16.10.2024

Numri i dokumentit: 06309534

**C.nr.1232/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË,**  
**Departamenti i Përgjithshëm / Divizioni Civil,** gjyqtari Selajdin Gallapeni, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Labinot Demiraj, në çështjen juridike të paditësve P. S, R. S, B. S, B. H, B. A, F. R, L. K, M. K, N. K, S. B, S. K– B, B. B, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit i autorizuari B. C, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Suharekës, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson i autorizuari A.B, përfaqësues ligjor i Komunës së Suharekës, për shkak, shpenzimeve të ushqimit, gjykata me qëllim të ekonomizimit të procedurës, jashtë shqyrtimit, më 16.10.2024, nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**- Pa shqyrtim kryesor -**

- I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësve; P. S, R. S, B. S, B. H, B. A, F. R, L. K, M. K, N. K, S. B, S. K – B, B. B, sa i përket kompensimit të shpenzimeve në emër të shujtave ditore, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Suharekës, Drejtoria e Arsimit në Suharekë, që paditëses:
- Paditëses P. S, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 03.10.2022, e deri me datë 21.11.2022, për 35 ditë pune, shumën prej 70.00 euro;
  - Paditëses R. S, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 03.10.2022, e deri me datë 21.11.2022, për 35 ditë pune, shumën prej 70.00 euro;

- Padi tëses B. S, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 03.10.2022, e deri me datë 21.11.2022, për 35 ditë pune, shumën prej 70.00 euro;
- Padi tësit B. H, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 03.10.2022, e deri me datë 21.11.2022, për 35 ditë pune, shumën prej 70.00 euro;
- Padi tëses B. A, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 03.10.2022, e deri me datë 21.11.2022, për 31 ditë pune, shumën prej 62.00 euro;
- Padi tësit F. R, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 03.10.2022, e deri me datë 21.11.2022, për 35 ditë pune, shumën prej 70.00 euro;
- Padi tëses L. K, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 03.10.2022, e deri me datë 21.11.2022, për 35 ditë pune, shumën prej 70.00 euro;
- Padi tëses M. K, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 03.10.2022, e deri me datë 21.11.2022, për 35 ditë pune, shumën prej 70.00 euro;
- Padi tësit N. K, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 03.10.2022, e deri me datë 21.11.2022, për 31 ditë pune, shumën prej 62.00 euro;
- Padi tësit S. B, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 03.10.2022, e deri me datë 21.11.2022, për 35 ditë pune, shumën prej 70.00 euro;
- Padi tëses S. B, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 03.10.2022, e deri me datë 21.11.2022, për 35 ditë pune, shumën prej 70.00 euro;
- Padi tëses B. B, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021, e deri me datë 21.11.2022, për 146 ditë pune, shumën prej 292.00 euro;

Të gjitha këto shuma me kamatë ligjore pre 8% në vit, ku kamata fillon të rrjedh nga data e paraqitjes së padisë 19.12.2023, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ne te kundërtën nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm.

- II. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumes së aprovuar si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Suharekës – Drejtoria e Arsimit, që paditësve t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në vlerë prej 333.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përbarimit të detyrueshëm, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve të kërkuara përtej shumes së aprovuar REFUZHET.

### A r s y e t i m

Paditëset, përmes të autorizuarit, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Suharekës, Drejtoria e Arsimit, me objekt të padisë kompensim i shujtave ditore. Ka shtuar se bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit, konkretisht në nenit 7, nder tjera thuhet, se te punësuarve në sistemin arsimor u sigurohet shpenzimet e ushqimit në shumën prej 2 euro për çdo ditë pune.

E paditura përmes përgjigjes në padi nuk e ka kontestuar bazën e padisë dhe kërkesëpadisë për kompensimin e shujtave ditore dhe i ka propozuar gjykatës që e njëjta të aprovohet pasi që me gjitha aktgjykimit që u kanë njohur të drejtën e shujtave janë vërtetuar edhe në Gjykatën e Apelit, ndërsa pjesën tjetër të refuzoi për shkak të parashkrimit duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës. Po ashtu i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve pas dates 21.11.2022, të refuzoj për shkak se është shfuqizuar Kontrata Kolektive e Arsimit.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkëngjitur padisë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore, pas çmuarjes me kujdes dhe me ndërgjegje të se cilës prej tyre dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

*Kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.*

Në nenin 143 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.”* Ndërsa në nenin 152 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata*

*mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

Nga analizimi i përgjigjes në padi rezulton fakti se e paditura nuk i ka kontestuar faktet vendimtare të kërkesëpadisë, me ç ‘rast për gjykatën është sajuar e drejta që në këtë çështje juridiko civile vendimmarrja të bëhet pa shqyrtim kryesor, me të vetmen arsye për zbatimin e ekonomizimit të procedurës, parim ky i sanksionuar dhe i urdhëruar për gjykatën për t’u zbatuar konform nenit 10 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore, siç parasheh: *“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”*

Në nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”*

I autorizuari i paditësve, me rastin e ngritjes së padisë, për kompensimin e shujtave ditore, i ka bashkëngjitur padisë vërtetimet lidhur me provimin e fakteve për ditët e punës, të cilat paraqiten si bazë për kërkimin e shumave të papaguara.

Bazuar në provat e lartcekur, shihet se kërkesa e paditësve gjen mbështetje të plotë në nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive, të lidhur më 01.09.2015, ndërmjet SBASHKU-ut dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, siç parasheh: *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare të institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të te punësuarve për ushqim.*

Lidhur me aprovimin e pikës një dispozitivit gjykata vendosi që t’ia falte besimin provave që kanë prezantuar paditësit, për faktin se janë nxjerrë nga një organ publike, bazuar në nenin 329 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore.

Gjykata vendosi sikurse në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumat përkatëse për faktin se paditësve iu takon të u njihet kompensimi i shujtave deri sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit, datë 21.11.2022, ku këto shuma u janë llogaritur së bashku me kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 28.11.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në lidhje me vendosjen si në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi që ta refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve për faktin se kanë kërkuar t’iu njihen shumat pas datës 21.11.2022, për çka vendosi gjykata ta refuzoj si të pabazuar.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së duke ia njohur paditësve shpenzimet e procedurës si në vijim: për përpilimin e padisë për 5 paditës 312.00 euro dhe shumën prej 21.00 euro në emër të taksës gjyqësore apo në shumë të përgjithshme prej 333.00 euro.

Nga të lartcekurat, e në kuptim të nenit 143 dhe 152 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2023:286838, 16.10.2024**

**G j y q t a r i**

**Selajdin Gallapeni**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2023:286838  
Datë: 16.10.2024  
Numri i dokumentit: 06309534